



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2018:063859

Datë: 05.03.2021

Numri i dokumentit: 01569717

P.nr. 421/2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN – dega Viti- Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarës së vetme gjyquese Blerina Jakupi Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit NN nga fshati Buzovik K. Viti, për shkak të veprës penale: pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1337/2015 të datës 31.08.2015, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar dhe jo publik me datë 24.02.2021, ndërsa me datë 25.02.2021 mori, shpalli dhe me dt. 05.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari NN, nga babai NN nëna NN, e lindur NN, i lindur me dt. 10.10.1993 në Gjilan, jeton në fshatin Buzovik K. Viti, i martuar, babë i katër (4) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal 1231045577.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

-me datë 10.08.2015, rreth orës 18:10 min, në Shtëpinë e Shëndetit-Urgjenca në Viti, i pandehuri e ka penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, mjekun, tani të dëmtuarin NN, në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari ishte duke e kontrolluar një pacient në ordinancën për kontrollë mjekësore, hyn i pandehuri së bashku me fëmiun e tij të sëmure dhe nga mjeku kërkon që ta ndërpret kontrollimin e atij pacienti dhe ta kontrollojë fëmiun e tij dhe pas marrjes së përgjigjes nga mjeku që i pandehuri të përgatisë fëmiun për kontrollim mjekësor, i pandehuri i mllëfosur fillimisht të dëmtuarin e kap për gjoksi dhe fyti dhe e përplas për muri, duke i shkaktuar të njëjtit lëndim të lehtë trupor, i cili për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore fillimisht në Shtëpinë e Shëndetit në Viti, e më pastaj edhe në Emërgjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, sipas raporteve mjekësore me nr. regj. 60/258 të dt. 10.08.2015 dhe nr. të protokolit 15822 të lëshuar me dt. 10.08.2015 nga Shtëpia e Shëndetit Viti dhe Emërgjenca e Spitalit Regjional-Gjilan.

- me çka ka kryer veprën penale: pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 7,17,38, 39, 40, 42, 44, 45, 69 dhe 70, të KPRK-ës, nenit 248 dhe nenit 365, të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit e lartëcekur, i shqipton:

DËNIM ME BURGIM I CILI DENIM ME PËLQIMIN E TË AKUZUARIT I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË

I.Ashtu që të akuzuarit NN për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi i caktohet denim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ashtu që denimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.

Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëqilimin e të akuzuarit, gjykata ka vendosur që denimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të njëjtit t'i zëvendësohet me denim me gjobë në shumë prej 950.00€ (nëntëqindëpesëdhjetë) euro, të cilin denim i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas ploguqishmërisë së aktgjykimit.

Duke u bazuar në nenin 43 parag.4 të KPRK-së, nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjëndje ta paguajë atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet në denim me burgim në atë mënyrë që për cdo 20 euro (njëzet euro) do t'i caktohet një ditë burgim.

Koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.10.08.2015 - 08.09.2015, të pandehurit duhet t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, në atë mënyrë që çdo 20 (njëzet) euro të dënimin me gjobë do të barazohen me 1 (një) ditë të arrestit shtëpiak dhe paraburgimit.

I dëmtuari NN, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 01.09.2015, ka dorëzuar në këtë Gjykatë aktakuzën me numër , PP.II.nr.1337/2015 të datës 31.08.2015, ndaj të akuzuarit NN nga fshati Buzovik K. Viti, për shkak të veprës penale: pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 24.02.2021, e cila seancë ishte jopublike duke u bazuar në vendimin e KGJK-ës sa i përket publicitetit edhe atë për shkak të pandemis COVID-19, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Sllavica Popoviq dhe i akuzuari NN, në të cilën seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale të lartcekur.

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë ndaj të

akuzuarit të lartcekur për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranonte fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari NN e ka kryer veprën penale: pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 4 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 248 të KPP-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, të njëjtit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të denuarit, gjykata ka vendosur që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të njëjtit t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 950.00€ (nëntëqindpesëdhjetë) euro, të cilin dënim i pandehuri do ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pas plogfuqishmërisë së aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjykata, me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që për të akuzuarin, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se i njëjti është penduar dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, është prind i 4 (katër) fëmijëve dhe është i vetmi person që kujdeset për ta, me punë të hërepashershme dhe nuk kanë të hyra materiale të rregullta, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e ka marrë për bazë shkallën e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale dhe dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar.

5.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marr parasysh rrethanat lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. Gjykata, po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38, të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6.Zëvendësimi i dënimit me burgim me dënim me gjobë.

Në bazë të nenit 44 të KPRK-ës në të cilin thuhet se “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë(6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar dhe gjykata ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe me pëlqimin e të denuarit e ka zëvendësuar me dënim me gjobë.

7.Llogaritje e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar

Neni 79 parag.1 të KPRK-ës parashihet se “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe cdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale logariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë”, andaj në rastin konkret i pandehuri NN nga data 10.08.2015-17.08.2015 ka qëndruar nën masën e paraburgimit, ndërsa nga dt. 17.08.2015-08.09.2015 ka qëndrura në masën e arrestit shtëpiak dhe gjykata i’a llogaritë në dënimin e shqiptuar me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në atë mënyrë që cdo 20 (njwzet) euro të dënimit me gjobë do të barazohen me një ditë të masës së arrestit shtëpiak.

8.Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Duke u bazuar në nenin 43 parag.4 të KPRK-ës nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjëndje ta paguajë atë atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për cdo 20 euro (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit Gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega Viti
P.nr.421/15
Me datë: 05.03.2021

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.